



Prishtinë, 15 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1435_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.8, Nenit 30, Nenit 32 paragrafin 2, nënparagrafi 2.3 dhe paragrafin 3, Nenit 34 dhe Nenit 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 15 të Ligjit për Energjinë Termike (Ligji Nr. 05/L-052) ;
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Nr.07/2017);
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Shpërndarjes së Energjisë, të dorëzuar në Rregullator me datë 23.03.2021 nga Ndërmarrja Publike Termokos SH.A., adresa Rr. 28 Nëntori Nr.138, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 15 tetor 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. I VAZHDOHET LICENCA për Shpërndarje të Energjisë Termike, ndërmarrjes "Ndërmarrja Publike Termokos SH.A." (në vijim Termokos), me numër licence ZRRE/Li_11/17, për periudhën prej pesëmbëdhjet (15) vitesh, nga data 15.10.2021 deri me datë 14.10.2036.
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për Ndërmarrjen Publike Termokos SH.A. të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (në vijim Rregullatori) me datë 23.03.2021 (ne formë elektronie) dhe me datë 28.07.2021 (përmes administratës) ka pranuar nga TERMOKOS-i, Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Vazhdim të Licencës Nr. ZRRE/Li_11/17 për aktivitet të Shpërndarjes së energjisë termike.
- o Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- o Në pajtim me Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, TERMOKOS-i me datë 24.09.2021 ka njoftuar palët e interesit përmes gazetave, se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të shërndarjes të energjisë termike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim nga palët e interesit, për këtë aplikacion.



- o Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- o Bordi i Rregullatorit ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të këtij aktivitetit dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kështu duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- o Licenca e lëshuar me datë **04 Tetor 2006**, (Nr. i Licencës ERO/Li_11/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_11/12), e modifikuar më 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_11/17) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë prej pesëmbëdhjetë (15) vitesh, deri më **14 tetor 2036**.
- o Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se **gjashtë (6) muaj** para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, Licencën e lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

**Bashkëngjitur licenca*

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes Ndërmarrja Publike Termokos SH.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buca, anëtar